



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

RREGULLORE (ZKM) NR. 06/2024
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E
VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË ANTIDOPING¹

¹ Rregullorja (ZKM) nr. 06/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Antidoping, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 029/2024, të datës 06.03.2024.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 28 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 5 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 08/L-152 për Antidopingun, në përputhje me nenin 9 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe në përputhje me nenin 9 (paragrafi 7) të Rregullores QRK nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 06/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË ANTIDOPING

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organizimit të brendshëm dhe i sistematizimit të vendeve të punës në Agjencinë Antidoping (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha njësitë përkatëse të Agjencisë.
2. Fusha e përgjegjësisë së Agjencisë përcaktohen në Ligjin nr. 08/L-152 për Antidopingun dhe legjisllacionin përkatës në fuqi.

Neni 3 Misioni i Agjencisë

Bazuar në veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjegjësitë ligjore, misioni i Agjencisë është promovimi, koordinimi dhe monitorimi i luftës kundër dopingut në sport në të gjitha format e tij, duke frymëzuar komunitetin e sportit dhe veçmas sportistët që të kenë besim në aftësitë e tyre për të pasur sukses në sport pa keqpërdorimin e substancave apo metodave të ndaluara, por atë ta arrijnë përmes lojës së ndershme dhe etike, performancës së shëndetshme, respektit për konkurrentët, zyrtarët, rregullat dhe integritetin e sportit.

Neni 4
Struktura organizative e Agjencisë Antidoping

1. Struktura organizative e Agjencisë Antidoping është si në vijim:
 - 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 - 1.2. Divizioni.
2. Agjencia udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv, i cili për punën e vet i përgjigjet ministrit përkatës për sport dhe e informon sekretarin e përgjithshëm të ministrisë përkatëse për sport (më tutje: drejtori).
3. Numri i të punësuarve në këtë Agjenci është dymbëdhjetë (12).

Neni 5
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Antidoping përbëhet nga:
 - 1.1. drejtori ekzekutiv;
 - 1.2. një (1) zyrtar/e ekzekutiv/e;
 - 1.3. një (1) zyrtar/e administrativ/e;
 - 1.4. një (1) zyrtar i lartë Ligjor.
 - 1.5 një (1) zyrtar i lartë ekzekutiv.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv përcaktohen me Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me Ligjin për Antidopingun dhe legjislacionin përkatës në fuqi për zyrtarët publikë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit profesional dhe mbështetës në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi për zyrtarët publikë.
4. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv.
5. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është pesë (5).

Neni 6
Divizioni i Agjencisë Antidoping

1. Në kuadër të Agjencisë Antidoping funksionon divizioni si në vijim:

1.1. Divizioni për Parandalimin e Dopingut në Sport.

Neni 7 **Divizioni për Parandalimin e Dopingut në Sport**

1. Misioni i Divizionit për Parandalimin e Dopingut në Sport është promovimi, koordinimi dhe monitorimi i luftës kundër dopingut në sport në të gjitha format e tij, duke frymëzuar komunitetin e sportit dhe veçmas sportistët që të kenë besim në aftësitë e tyre për të pasur sukses në sport pa keqpërdorimin e substancave apo metodave të ndaluara, por atë ta arrijnë përmes lojës së ndershme dhe etike, performancës së shëndetshme, respektit për konkurrentët, zyrtarët, rregullat dhe integritetin e sportit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Parandalimin e Dopingut në Sport janë:

2.1. sigurimi i zbatimit të politikave programore dhe standardeve të punës për edukimin, ekzekutimin e testeve dhe inteligjencës për antidopingun dhe menaxhimin e rezultateve;

2.2. monitorimi i proceseve të edukimit, testimit, inteligjencës dhe hetimit, menaxhimit të rezultateve brenda divizionit;

2.3. mbikëqyrja e zbatimit të programeve për edukim, testim, inteligjencë dhe hetim;

2.4. mbështetja dhe ofrimi i këshillave për drejtorin për fushën e edukimit, testimit, inteligjencës dhe hetimeve, menaxhimit të rezultateve;

2.5. organizimi dhe menaxhimi i të gjitha trajnimeve në fushën e mbledhjes së mostrave, menaxhimit të rezultateve, edukimit dhe inteligjencës në lidhje me shkeljen e rregullave antidoping sipas nevojave të Agjencisë;

2.6. hartimi i planit të trajnimeve për personelin për mbledhjen e mostrave dhe monitorimi i zbatimit të tij në bazë të nevojave të përcaktuara nga njësitë e tjera organizative;

2.7. bashkërendimi i programeve të punës për edukim, testim, inteligjencë dhe hetim dhe menaxhim të rezultateve;

2.8. hartimi dhe dorëzimi i raporteve të punës javore, mujore, periodike dhe vjetore për Drejtorin Ekzekutiv;

2.9. promovimi i veprimtarisë së Agjencisë dhe aktiviteteve vetëdijesuese.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Parandalimin e Dopingut në Sport raporton te drejtori ekzekutiv.

4. Numri i të punësuarve në kuadër të këtij divizioni është shtatë (7).

Neni 8
Shërbimet e përgjithshme

Shërbimet financiare, të certifikimit, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të auditimit të brendshëm në Agjenci kryhen nga njësitë përkatëse të ministrisë përkatëse për sport.

Neni 9
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin përkatës për shërbimin civil brenda kategorisë është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
2. Numri i punëtorëve dhe financimi i kësaj rregullore zbatohet sipas ligjit vjetor të buxhetit të shtetit.
3. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit bëhet në pajtim me Ligjin për Buxhetin Vjetor, përveç rasteve kur krijohen dhe/apo shuhen struktura organizative.

Neni 10
Shtojcat

Përshkrimi i detyrave të vendeve të punës të zyrtarëve dhe struktura organizative e Agjencisë përcaktohen sipas shtojcave, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

06 mars 2024

SHTOJCA I

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË ANTIDOPING				
POZITA/STRUKTURA	KLASA	GRUPI (I PËRGJITHSHËM OSE IVEÇANTË)	NUMRI	TOTALI
1. ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV				5
- Drejtor/eshë ekzekutiv/e	- Drejtues i lartë 2		1	
- Zyrtar ekzekutiv	- Profesional 2	58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1	
- Zyrtar administrativ	- Profesional 3	58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1	
- Zyrtar/e i/e lartë Ligjor	- Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1	
- Zyrtar/e i/ e lartë ekzekutiv	- Profesional 1	4. Gr. Specialist i ekonomisë	1	
2.1. Divizioni për parandalimin e dopingut në Sport				7
- Udhëheqës/e i/e divizionit për parandalimin e Dopingut në Sport	- Drejtues i Ulët		1	
- Zyrtar/e i/e lartë për testim	- Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1	
- Zyrtar/e i/e lartë për zbulim, gjurmim dhe hetim	- Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1	
- Zyrtar/e i/e lartë për edukim	- Profesional 1	58. Gr. Specialist administrimit të përgjithshëm	1	
- Zyrtar/e për kontrollë të dopingut	- Profesional 2	58. Gr. Specialist administrimit të përgjithshëm	1	
- Zyrtar i lartë për menaxhim të rezultateve	- Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1	
- Zyrtar administrativ	- Profesional 3	58. Gr. Specialist administrimit të përgjithshëm	1	
Totali				12

